

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (Seancë e hapur)

Faqe 1

1 E enjte, 4 maj 2023

2 [Seancë e hapur]

3 [I akuzuari merr pjesë përmes videolidhjes]

4 --- Seanca fillon në orën 14.00

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

6 Mirëdita. Mirë se erdhët.

7 Znj. Sekretare e Gjykatës, paraqisni lëndën ju lutem.

8 SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Kjo është çështja KSC-  
9 BC-2020-04, Prokuroria i Specializuar kundër Pjetër Shalës.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

11 Faleminderit.

12 Fillimisht do t'ju kërkoja palëve dhe Mbrojtësit të  
13 Viktimave të na thonë kush është i pranishëm.

14 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Mirëdita, të nderuar Gjykatës.  
15 Nga ana e Prokurorisë, Line Pedersen, menaxheren e çështjes,  
16 Gaia Pergolo, Eva Wyler, Filippo de Minicis, ndihmësprokuror.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

18 Mbrojtësi i Viktimave.

19 Z. LAWS: [Përkthim] Mirëdita. Unë jam Simon Laws,  
20 përfaqësoj Viktimat në këtë çështje ligjore, bashkë me  
21 bashkëmbrojtësen Maria Radziejowska.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

23 Faleminderit.

24 Avokat, fjala është për ju.

25 Z. GILISSEN: [Përkthim] Mirëdita. Faleminderit. Unë jam

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (Seancë e hapur)

Faqe 2

1 Jean-Louis Gilissen. Dhe jam këtu me znj. Petravica, menaxhere  
2 e çështjes dhe z. Shala na ndjek me videolidhje nga objekti i  
3 paraburgimit. Faleminderit.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
5 Faleminderit.

6 Z. Shala, a mund të më thoni nëse më dëgjoni?

7 I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Ju ndëgjoj. Mirëdita ma  
8 s'pari. Ju ndëgjoj shumë mirë. Faleminderit.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A  
10 mund ta përsërisni, ju lutem?

11 I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Mirëdita së pari. Ju  
12 dëgjoj shumë mirë. Faleminderit.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Sot  
14 pasdite jemi mbledhur për të nxjerrë një sërë vendimesh dhe  
15 urdhrash me gojë për çështje që janë në pritje për vendim nga  
16 ana e Trupit Gjykes. Gjithashtu do ju komunikojmë edhe  
17 kalendarin deri në janar 2024 për seancat, si dhe do t'ju  
18 japim dhe disa referenca për procesverbal që lidhen me  
19 versionet e gjuhës shqipe të dy dokumenteve që ju paraqitën  
20 dëshmitarit dhe gjatë marrjes në pyetje.

21 Kërkon pak kohë, por ideja është që të përshpejtojmë  
22 procesin gjyqësor.

23 Do të filloj me referencat. Që janë si në fillim, do të  
24 flas ngadalë se ka shumë numra. Referenca e parë është 059351-  
25 TR-ET RED4, faqja 17, rreshtat 8 deri në 10, që i përkojnë

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (Seancë e hapur)

Faqe 3

1 materialit 059351-TR-AT, Pjesa 3, RED4, faqja 19, rreshtat 1  
2 deri në 3.

3 Shoh që tek përkthimi i anglishtes duhet të kisha thënë  
4 po ashtu Pjesa 3.

5 Referenca e dytë është SITF00013047-SITF00013060 RED5,  
6 faqja 13 dhe është, i përkon materialit SITF00010075 deri  
7 SITF00013088 RED5, faqja 13.

8 Tani të flas për kalendarin e seancave nga gushti e në  
9 vijim, sepse deri në korrik e kemi nxjerrë. Duke parë parasysh  
10 që sallën e gjyqit duhet ta ndajmë dhe me Trupin tjetër  
11 Gjykses, ne kemi përcaktuar këto data: Java e parë është në  
12 gusht është në gusht është 21 deri në 25 gusht; pastaj 18 deri  
13 në 22 shtator; pastaj do të kemi seanca 2, 3 dhe 4 tetor; më  
14 pas nga data 23 deri në 27 tetor; vazhdojmë 20 nëntor deri më  
15 1 dhjetor; dhe në janar, nga data 15 deri në 19 janar 2024.

16 Tani, vendimet dhe urdhrat me gojë. Kemi pesë gjithsej.

17 Trupi Gjykses fillimisht do të nxjerrë vendim me gojë sa  
18 i takon nocionit të Prokurorisë së Specializuar për pranimin e  
19 provave të Dëshmitarit 1 në bazë të rregullës 154 të  
20 Rregullores së Procedurës dhe Provave që është parashtrim i  
21 protokolluar 465 i 20 marsit 2023.

22 Në kërkesë, ZPS-ja kërkon që të pranohen si prova  
23 deklaratat e mëhershme me shkrim të Dëshmitarit 1 që ka marrë  
24 ZPS-ja si dhe materiale shoqëruese në rast se përmbushen  
25 kërkesat e rregullës 154 të Rregullores.

1 ZPS-ja parashtron se pranimi i materialeve lidhur këtë  
2 dëshmitar do të mundësojë një vlerësim të plotë të këtij  
3 dëshmitari ndërsa pyetjet e drejtpërdrejta mund të fokusohen  
4 në çështje që janë në themel të çështjes gjyqësore, si  
5 rifreskimi i kujtesës së dëshmitarit, vendosja e pyetjeve në  
6 kontekst, si dhe marrja e dëshmimeve lidhur me aspekte të  
7 rëndësishme të rrëfimit të dëshmitarit. Kjo nga ana tjetër do  
8 të ndihmojë që të ulet numri i orëve që nevojiten për pyetjet  
9 e drejtpërdrejta.

10 Kemi marrë kundërshtime lidhur me këtë kërkesë nga  
11 Mbrojtja në materialin 485. Më 14 prill 2023. Dhe Mbrojtja e  
12 parashtron se duke e mbajtur parasysh historikun e këtij  
13 dëshmitari, si dhe kontradiktat në dëshminë e tij, materiali  
14 që kërkohet për t'u pranuar nga Prokuroria nuk është i  
15 besueshëm dhe duhet të konstatohet si material i papranueshëm  
16 për të garantuar të drejtën e të akuzuarit për një gjykim të  
17 drejtë.

18 Në alternativë, në rast se Trupi Gjyqësor e pranon  
19 materialin, Mbrojtja kërkon gjithashtu që të pranohen si prova  
20 disa materiale që lidhen me karakterin e dëshmitarit,  
21 besueshmërinë edhe të shkuarën e tij kriminale.

22 Kemi marrë dhe kundërpërgjigje nga ZPS-ja në materialin  
23 493, me datën 24 prill 2023, se mospërputhshmëritë që  
24 pretendon Mbrojtja në materialin e ofruar nga ZPS-ja janë  
25 çështje që duhet t'i eksplorojë Mbrojtja në kundrapyetje, nëse

1 dëshiron dhe t'i vlerësojë Trupi Gjykses gjatë momentit që  
2 bëhet dhe gjykimi. Sa i takon materialeve që kërkon Mbrojtja  
3 për t'u pranuar, ZPS-ja pretendon se kërkesa nuk është e  
4 vlefshme sepse ka ardhur në formën e një përgjigjeje. Krahas  
5 kësaj, ZPS-ja parashtron që materialet nuk përmbushin  
6 standardin e provueshmërisë sipas rregullës 138(1) e  
7 Rregullores dhe duhen rrëzuar.

8 Fillimisht, Trupi Gjykses rikujton se është në  
9 kompetencat e tij të përcaktojë formën më të përshtatshme të  
10 dëshmisë apo modalitetin e parashtrimit si provë për çdo  
11 material dhe çdo provë që palët kërkojnë të ofrojnë.

12 Në këtë kuadër rregullat 153, 154 dhe 155 të Rregullores  
13 janë rrugë alternative ndaj një dëshmie të plotë me gojë, e  
14 cila rregullon skenarë specifike dhe të ndryshëm po që kanë  
15 qëllimin e përbashkët përshpejtimin edhe efikasitetin e  
16 procesit gjyqësor, por ndërkohë duke respektuar edhe  
17 drejtësinë e gjithë procesit, në tërësi.

18 Sa i takon rregullës 154 të Rregullores konkretisht,  
19 Trupi Gjykses vlerëson se arsyetimi lidhur me këtë modalitet  
20 të parashtrimit të provave mbështetet në ofrimin si provë në  
21 deklaratat e mëhershme të dëshmitarit dhe materialet  
22 bashkëshoqëruese dhe më pas të vlerësohen në Gjykatë shkurt,  
23 të vlerësohet saktë, pra, saktësia e këtyre provave në praninë  
24 e dëshmitarit në fjalë që më pas mund të përdoren te  
25 kundrapyetjet e palës tjetër. Në këtë formë, rregulla 154 e

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (Seancë e hapur)

Faqe 6

1 Rregullores lejon që të kursehet koha dhe të shfrytëzohet më  
2 së miri, po në të njëjtën kohë respektohet dhe një proces i  
3 drejtë dhe të drejtat e palës kundërshtare për të pyetur  
4 kundërpyetur dëshmitarin në mënyrë të një mend.

5 Sipas ZPS-së edhe Mbrojtjes, Dëshmitari 1 është dëshmitar  
6 i rëndësishëm dhe i kontestuar dhe nuk mund të vendoset  
7 paraprakisht që dëshmia që mund të japë ky person mund të ketë  
8 mospërputhshmëri të mundshme dhe kontradikta. Krahas kësaj, do  
9 të duhet sidoqoftë një kohë e konsiderueshme dhe jo më pak se  
10 tetë orë sipas ZPS-së, për të përfunduar procesin që i  
11 nevojitet këtij dëshmitari për të dhënë dëshmi në këtë sallë  
12 gjyqi në raport me deklaratën e tij të mëhershme në përputhje  
13 me rregullën 154(c) të Rregullores.

14 Trupi Gjykses vlerëson se duke marrë parasysh natyrën e  
15 dëshmisë që pritet të japë ky dëshmitar, përfshirë ndonjë  
16 mospërputhshmëri dhe kontradiktë të mundshme lidhur me aspekte  
17 të rëndësishme të dëshmisë së tij, deklaratat e mëhershme që  
18 palët mund t'i paraqesin dëshmitarit, sikurse del nga  
19 parashtrimet e tyre, si dhe koha që nevojitet nga ZPS-ja për  
20 të përfunduar pyetjet e vete të drejtpërdrejta, atëherë provat  
21 e këtij dëshmitari, sipas Trupit Gjykses, nuk janë të  
22 përshtatshme për procesin gjyqësor në përputhje me rregullën  
23 154 të Rregullores.

24 Trupi Gjykses konstaton se forma më e përshtatshme për  
25 t'i paraqitur provat Dëshmitarit 1 është përmes dëshmisë së

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (Seancë e hapur)

Faqe 7

1 plotë *viva voce*, për këtë arsye Trupi Gjykues rrëzon kërkesën  
2 e ZPS-së dhe urdhëron ZPS-në të thërrasë Dëshmitarin 1 që të  
3 japë dëshmi në mënyrë të drejtpërdrejtë tërësisht.

4 Trupi Gjykues do t'i paraqesë ZPS-së, Mbrojtjes dhe  
5 Mbrojtësit të Viktimave mundësinë për të eksploruar plotësisht  
6 aspekte të tjera përkatëse që e gjykojnë të rëndësishme dhe  
7 t'i paraqesin dëshmitarit çdo deklaratë të mëhershme dhe  
8 material që e gjykojnë të rëndësishëm. Në këtë drejtim, Trupi  
9 Gjykues vlerëson se ZPS-ja mund të ketë nevojë për më shumë  
10 kohë se çka parashikuar fillimisht. Rrjedhimisht, Trupi  
11 Gjykues urdhëron ZPS-në të dorëzojë, brenda të premtës, 12 maj  
12 2023, një përlllogaritje të përditësuar të kohës që i nevojitet  
13 për të marrë në pyetje Dëshmitarin 1, duke marrë parasysh  
14 faktin që se dëshmitari do të dëshmojë në mënyrë të  
15 drejtpërdrejtë tërësisht.

16 Kërkesa alternativë e Mbrojtjes për të paraqitur disa  
17 materiale është e tejkaluar.

18 Me këtë mbyll vendimin me gojë për këtë aspekt.

19 Kemi një vendim me gojë lidhur me kërkesën e Prokurorit  
20 të Specializuar për të ndryshuar listën e provave materiale që  
21 është parashtrimi 488, i datës 19 prill 2023. ZPS-ja kërkon që  
22 të shtojë në listën e provave materiale një paketë dokumentesh  
23 zyrtarë, një sërë dokumentesh zyrtar, fotografi dhe video të  
24 vendeve të pretenduara ku kanë ndodhur krimet, që janë  
25 mbledhur pas një vizite që është bërë në këtë vend nga ZPS-ja

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (Seancë e hapur)

Faqe 8

1 në fillim të këtij viti.

2 E pamë që kemi konstatuar që Mbrojtja nuk ka paraqitur  
3 kundërshtim lidhur me këtë kërkesë. Që është parashtrimi 498,  
4 1 maj 2023.

5 Nuk kemi marrë asnjë parashtrim as prej Mbrojtësit të  
6 Viktimave

7 Trupi Gjykses është i bindur se kërkesa është dorëzuar në  
8 kohë dhe është dorëzuar menjëherë pasi është marrë materiali.  
9 Dhe Trupi Gjykses është i mendimit se mund ta ndihmojë Trupi  
10 Gjykses që të kuptojë vendin e mundshëm e pretenduar të  
11 krimit. Dhe po ashtu, vëmë re se s'ka asnjë kundërshtim nga  
12 Mbrojtja.

13 Dhe e miratojmë kërkesën. ZPS-ja do ja nxjerrë materialin  
14 Mbrojtjes dhe Mbrojtësit të Viktimave, në qoftë se nuk e ka  
15 bërë tashmë. Si ju kërkojmë të dorëzoni një listë të  
16 përditësuar të provave materiale brenda 12 majit 2023, e  
17 premtë.

18 Kemi marrë parasysh parashtrimin e Mbrojtjes sa i takon  
19 vizitës në vendin e krimit dhe me këtë, pra, i referohemi  
20 vendimit tonë mbi zhvillimin e gjykimit që është parashtrimi  
21 434, paragrafi 74, ku kemi treguar sesi duhet vepruar.

22 Nuk mendojmë se përgjigja jua, Avokat Mbrojtës, që është  
23 materiali 498, mund të riklasifikohet si publike pa redaktime  
24 sepse përmban informacion konfidencial. Do të donim të lutnim  
25 që të shihnit me kujdes kërkesën ose të t'i shihni me kujdes



Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (Seancë e hapur)

Faqe 9

1 materialet përpara se të kërkon riklasifikim, se materiali që  
2 është redaktuar në kërkesën e ZPS-së që shfaqet dhe në  
3 përgjigjen tuaj, duhet të mbetet konfidencial.

4 Nëse nuk jeni dakord me redaktimet që ka bërë ZPS-ja, ju  
5 lutem informoni Trupim Gjykses, ta diskutojmë më tej.

6 Z. GILISSEN: [Përkthim] Sa më shpejt që të kemi mundësi  
7 do ta bëjmë këtë, të nderuar Gjykatës.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
9 Atëherë, ju kërkojmë të dorëzoni një version të redaktuar  
10 publik për parashtrimin e protokolluar 498 brenda të premtës,  
11 12 maj. Që është java tjetër.

12 Po ashtu ju urdhërojmë të dorëzoni version të redaktuar  
13 publik të parashtrimin të protokolluar 437 brenda të njëjtës  
14 ditë, në të njëjtën datë edhe kjo është në vijim të vendimit  
15 482, paragrafi 23(c) lidhur me këtë aspekt. Nuk po jap  
16 informacion të mëtejshëm për shkak të natyrës së këtij  
17 parashtrim të protokolluar.

18 Me këtë mbyll vendimin me gojë dhe për këtë aspekt.

19 Së treti është urdhër me gojë ku përcaktojmë hapa të  
20 mëtejshëm procedural për paraqitjen e prova nge Mbrojtësi i  
21 Viktimave.

22 Trupi Gjykses rikujton, i nderuar Mbrojtësi i Viktimave,  
23 se kemi vendosur se viktimat duhet të paraqesin provat e tyre,  
24 nëse kanë, pas ZPS-së dhe para Mbrojtjes. Nëse viktimat  
25 dëshirojnë të paraqesin mendimet dhe shqetësimet e tyre para

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (Seancë e hapur)

Faqe 10

1 Trupit Gjykues, mund ta bëjnë këtë pasi ka mbyllur provat ZPS-  
2 ja dhe para se të filloj paraqitjen e provave Mbrojtja.  
3 Paraqitja e provave, pikëpamjeve dhe shqetësimet nga viktimat  
4 është në varësi të vendimeve që nxjerrë Trupi Gjykues në bazë  
5 të rregullës 130 të Rregullores. Dhe kjo është në përputhje me  
6 vendimin 433, paragrafët 38, 40 dhe 45, si dhe vendimin 434,  
7 paragrafi 9 edhe 10. Gjithashtu ju sjellim në kujtesë që të  
8 kryejmë proces penal dhe procesin e zhdëmtimit në të njëjtën  
9 kohë.

10 Për të organizuar paraqitjen e provave nga viktimat, nëse  
11 ka, Trupi Gjykues i jep këto udhëzime Mbrojtësit të Viktimave.  
12 Edhe këto udhëzime lidhen si me paraqitjen e provave për  
13 gjetjen e të vërtetës, për përcaktimin e të vërtetës si dhe në  
14 kuadër të zhdëmtimit, në qoftë se Trupi Gjykues del me vendim  
15 fajësie. Sigurisht, kjo nuk cenon vendimin përfundimtar të  
16 Trupit Gjykues sa i takon fajësisë apo pafajësisë së të  
17 akuzuarit dhe çdo urdhër zhdëmtimi që mund të burojë prej  
18 këtij vendimi.

19 Pikë së pari, ne ju udhëzojmë që të dorëzoni, brenda 30  
20 qershorit 2023, një listë të dëshmitarëve që propozoni të  
21 thërrisni, përfshirë dëshmitarët ekspertë, si sa i takon  
22 përcaktimit të së vërtetës dhe në kuadër të zhdëmtimeve. Lista  
23 duhet të respektojë udhëzimet që ka dhënë Trupi Gjykues në  
24 vendimin 433, paragrafi 42 dhe vendimin 434, paragrafi 28, 32,  
25 35 dhe 68.

1 Trupi Gjykses ju kërkon, që kur dorëzoni listën, të jepni  
2 konstatimet konkrete nëse synoni të paraqisni prova prej  
3 ekspertëve sa i takon dëmit fizik, mendor dhe material që  
4 pretendohet që kanë vuajtur viktimat e drejtpërdrejta në  
5 kuadër të gjetjes së të vërtetës apo për qëllim zhdëmtimi apo  
6 për të dyja.

7 Trupi Gjykses është në dijeni se, në fakt, ju e keni  
8 udhëzuar një psikologjist ekspert, por dëshirojmë të dimë nëse  
9 synoni që të paraqisni aktekspertiza lidhur me dëmin fizik dhe  
10 material që kanë vuajtur apo që kanë pësuar viktimat e  
11 drejtpërdrejta. Në qoftë se jo, ju duhet të jepni konstatimet  
12 tuaja sesi parashikoni që të kryhet vlerësimi i dëmit fizik  
13 dhe material që pretendohet se kanë vuajtur viktimat e  
14 drejtpërdrejta, në qoftë se ka. Gjithashtu, duhet të jepni  
15 mendimet tuaja apo parashtrimet tuaja si mendoni që ta bëni  
16 përllogaritjen e kompensimin për dëmin e pretenduar që  
17 mendohet se është bërë nga pikëpamja financiare. Dhe këtu  
18 përfshihen të gjitha llojet e dëmeve dhe, sigurisht, nuk cenon  
19 llojet dhe modalitete e zhdëmtimeve që mund të kërkojë në  
20 përfundim Mbrojtësi i Viktimave.

21 Po ashtu, ju udhëzojmë të paraqisni parashtrime nëse  
22 synoni të paraqisni aktekspertiza sa i takon dëmit mendor dhe  
23 material që pretendohet se kanë vuajtur viktimat e tërthorta  
24 në kuadër të zhdëmtimit. Në qoftë se jo, ju duhet të paraqisni  
25 vlerësimet tuaja si parashikoni të bëhet vlerësimi i kuadrit

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (Seancë e hapur)

Faqe 12

1 dhe shtrirjes së dëmit të pretenduar nga këto viktimat, në  
2 qoftë se ka. Më tej, gjithashtu, duhet të paraqisni  
3 parashtrimet tuaja si parashikoni të bëhet përllogaritja e  
4 kompensimit për dëmin e pretenduar nga pikëpamja financiare,  
5 në qoftë se ka. Këtu përfshihen të gjithë llojet e dëmeve që  
6 kanë pësuar këta persona dhe nuk cenon llojet dhe modalitetet  
7 e zhdëmtimeve që mund të kërkojë në përfundim Mbrojtësi i  
8 Viktimave.

9 Çdo aktekspertizë do të dorëzohet jo më vonë se 30  
10 qershori edhe krahas aktekspertizave duhet të dorëzoni dhe  
11 informacion sa i takon kualifikimit të këtyre ekspertëve,  
12 përfshirë kurikulat e tyre, kurikulimin e tyre.

13 Nëse nevojiten redaktime përkundrejt palëve, ju lutem  
14 bëni kërkesën, bëheni paraprakisht, në mënyrë që t'i jepni  
15 mundësi Trupi Gjykses që të marrë vendim lidhur me këtë  
16 kërkesë përpara afatit 30 qershorit 2023.

17 Ju lutem bëni kërkesë për çdo ndryshim masash mbrojtëse  
18 që janë miratuar për viktimat, si mbas nevojës, për të  
19 mundësuar nxjerrjen e identiteteve dhe materialeve ekspertëve,  
20 duke përcaktuar materialin e saktë që dëshironi të zbuloni.

21 Mbrojtja do të ketë shtatë ditë nga njoftimi i raporteve  
22 për të kundërshtuar cilësimin e ekspertëve apo të raporteve,  
23 ZPS-ja mund ta bëjë këtë brenda shtatë ditësh por vetëm në  
24 masën që raportet lidhen me vërtetimin e të vërtetës. Për  
25 ekspertët e propozuar të thirren në lidhje me provimin e të

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (Seancë e hapur)

Faqe 13

1 vërtetës, rregulla 149 e Rregullores do të zbatohet, 149 do të  
2 zbatohet. Për ekspertët e thirrur për qëllimi reparacionesh  
3 apo zhdëmtimesh, dëshmia e tyre do të merret dhe vlerësohet si  
4 rregull me shkrim. Dhe Trupi Gjykses i referohet për këtë gjë  
5 paragrafit 10 të vendimit 425 në Çështjen 05, që është publik.

6 Së dyti, Mbrojtësi i Viktimave, vijmë ke dëshmia jo  
7 gojore. Ju udhëzojmë, që deri në 17 korrik 2023, të dorëzoni  
8 çdo provë jo gojore që kërkon të paraqisni duke treguar nëse  
9 ka të bëjë me vërtetimin e të vërtetës dhe/ose zhdëmtimet.  
10 Trupi Gjykses kujton se viktimave nuk u kërkohet të japin të  
11 dhëna për shpenzimet e trajtimeve mjekësore që kanë pësuar ata  
12 apo të afërmit e tyre, apo për dëmtime me natyrë financiare,  
13 në qoftë se të dhëna të tilla janë të disponueshme, ju  
14 kërkohet që t'i paraqisni. Dhe kam parasysh, për shembull,  
15 dëshminë e Dëshmitarit 6 në Gjykatë.

16 Në qoftë se janë të nevojshme të bëhen redaktimet, ju  
17 lutem bëheni kërkesë, paraprakisht, që t'i jepni mundësi  
18 Trupit Gjykses të japë vendim përpara datës 17 korrik 2023.

19 Dhe, së fundi, nëse prej viktimave që marrin pjesë në  
20 proces, dëshirojnë të paraqesin pikëpamje dhe shqetësimet e  
21 tyre, Mbrojtësi i Viktimave, duhet të informoni Trupin Gjykses  
22 dhe të kërkon autorizim përkatësisht po ashtu deri në 30  
23 qershor 2023. Udhëzimet e Trupit Gjykses që i kemi lëshuar në  
24 vendimin 433, paragrafi 42 dhe vendimin 434, paragrafët 28, 32  
25 dhe 35, do të zbatohen *mutatis mutandis* dhe në masën e

1 nevojshme.

2 Më pas do të trajtojmë çështjen e kohës dhe përmbajtjes  
3 së kërkesave për zhdëmtime.

4 Mbrojtësi i Viktimave mund të paraqesë vëzhgimet e tij  
5 për këtë çështje deri në 30 qershor 2023 dhe Mbrojtja do bëjë  
6 të njëjtën gjë deri më 12 korrik 2023, duke përfshirë çdo  
7 përgjigje ndaj parashtimeve të Mbrojtësit të Viktimave.

8 Trupi Gjykses parashikon që provat e paraqitura nga  
9 Mbrojtësi i Viktimave duke përfshirë dhe provat e ekspertëve  
10 dhe eventualisht pikëpamjet, shqetësimet e viktimave  
11 pjesëmarrëse, duhet të paraqiten gjatë javës 21 deri 25 gusht  
12 2023. Nëse kjo nuk është e mundur, paraqitja e tyre duhet bërë  
13 më e vona në javën e 18 deri në 22 shtator 2023.

14 Mbrojtësi i Viktimave, janë shumë gjëra, por a i keni të  
15 qarta këto që thashë?

16 Z. LAWS: [Përkthim] Po.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
18 Gjithashtu jemi të interesuar të mësojmë se ku jeni lidhur me  
19 psikologun ekspert? A mund të na përditësoni lidhur me këtë  
20 çështje? Nëse duhet të shkojmë në seancë private, e bëjmë.

21 Z. LAWS: [Përkthim] Nuk besoj që kemi nevojë. Është duke  
22 u përkthyer. Por duhen ndjekur disa hapa pasi të përkthehet  
23 dhe do të kërkojnë pak kohë. Nuk mund ta japim përkthimin  
24 menjëherë, por është në rrugë e sipër.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

1 Faleminderit për informacionin.

2 Dhe këtu përfundon urdhri me gojë i Trupit Gjykses për  
3 këtë çështje.

4 Kemi dhe një urdhër të katërt me gojë, që ka të bëjë me  
5 vëzhgimet e bëra nga Mbrojtja në fillim të kësaj jave në  
6 lidhje me gamën e specificitetin e akuzave. E kam parasysht për  
7 këtë transkriptin provizor në faqen 1129, rreshti 22, deri në  
8 faqen 1134, rreshti 13 dhe faqen 1137, rreshti 17, deri në  
9 faqen 1140, rreshti 25 të projektranskriptit të datës 1 dhe 2  
10 maj, si për parashtrimet e Mbrojtjes edhe të ZPS-së.

11 Trupi Gjykses kujton se çështjet e lidhura me gamën dhe  
12 specificitetin e akuzave dhe çdo defekt në formën e aktakuzës,  
13 duhet të ngrihet në fazën paraprake të çështjes sipas  
14 rregullës 97 të rregullores. Vëzhgimet e Mbrojtjes janë, pra,  
15 rrjedhimisht, të parakohshme. Për më tepër, këto çështje janë  
16 diskutuar si nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake dhe nga  
17 Paneli i Gjykatës së Apelit dhe për këto janë marrë vendime.  
18 Dhe e kam fjalën te vendimi IA004 F0008.

19 Në këtë fazë, Trupi Gjykses mendon se Mbrojtja duhet të  
20 vendosë për çështje dhe aspekte për të cilat dëshiron të bëjë  
21 pyetje dhe për të marrë prova apo, në një plan më të  
22 përgjithshëm, për mënyrën sesi do ta paraqesë çështje e saj.  
23 Këtë çështje nuk do ta trajtojmë më tej.

24 Këtu përfundon urdhri me gojë për këtë çështje.

25 Dhe së fundi, Trupi Gjykses i kthehet kërkesës së bërë

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (Seancë e hapur)

Faqe 16

1 nga Mbrojtësi i Viktimave dhe lidhur me listën e dokumenteve  
2 që do të përdorin nga palët dhe nga Mbrojtësi i Viktimave  
3 gjatë pyetjeve të tyre. Dhe kjo ishte në faqen 1347, rreshti  
4 18, deri në faqen 1348, rreshti 9, në transkriptin provizor të  
5 djeshëm.

6 Ne me sa kuptojmë është bërë një marrëveshje midis ZPS-së  
7 dhe Mbrojtjes për këtë çështje. Desha të dëgjoja nëse jeni  
8 dakord.

9 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Po. Pajtohemi me këtë.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

11 Mbrojtësi i Viktimave [sipas përkthimit]?

12 Z. GILISSEN: [Përkthim] Edhe ne po ashtu.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Desha  
14 ta kishim për procesverbal. Në rregull.

15 E mirëpresim propozimin tuaj, Mbrojtësi i Viktimave dhe e  
16 ndryshojmë vendimin tonë për kryerjen e procedurës, që është  
17 parashtrimi i protokolluar 434, rrjedhimisht, konkretisht  
18 paragrafi 48. Pala që nuk do të thërresë dëshmi nxjerrë listën  
19 e dokumenteve që do të paraqesë por që përfshin vetëm ato  
20 materiale që nuk janë të pranishëm në listën e materialeve të  
21 palës thirrëse.

22 Dhe këtu përfundon edhe urdhri gojor për këtë çështje.

23 Pra, mbaruam me vendimet gojore. Ju treguam planin e  
24 seancave deri në janar 2024 dhe ju kemi dhënë dhe referencat.

25 Do t'ju japim fjalën për të parë nëse doni të diskutoni



Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (Seancë e hapur)

Faqe 17

1 diçka me Trupin Gjykses, po e përsërit, siç ua kemi komunikuar  
2 ndërkohë, më duket të hënën, se 19 maji qëndron si ditë pune,  
3 si ditë për seancë në rast na duhet të diskutojmë ndonjë  
4 çështje procedurale. Apo do të japim urdhra gojorë në vend që  
5 të japim me shkrim. Pra, çështje që mund të dalin përpara  
6 bllokut të tretë të provave. Do ta komunikojmë të martën, në  
7 datën 16, nëse do të punojmë të premtën, në 19. Sigurisht,  
8 nëse e dimë paraprakisht.

9 Po, tani do t'ju drejtohem si zakonisht.

10 Juve të Prokurorisë?

11 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Asgjë nuk kemi.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

13 Mbrojtësi i Viktimave?

14 Z. LAWS: [Përkthim] As ne nuk kemi asgjë.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

16 Mbrojtësi i Viktimave [sipas përkthimit].

17 Z. GILISSEN: [Përkthim] As ne nuk kemi.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në

19 rregull.

20 Atëhere, nëse nuk do të kemi seancë në datën 19, do të  
21 rifillojmë në fund të majit.

22 Ju falënderoj për pjesëmarrjen në këtë seancë sot  
23 pasdite. Falënderoj Njësinë e Menaxhimit të Gjykatës për  
24 ndihmën e tyre gjatë gjithë javë, të njëjtën gjë kam dhe për  
25 përkthyesit, stenografen, sigurinë dhe teknikët.

1 Këtu përfundon seanca.

2 --- Seanca mbyllet në orën 14.33

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25